



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:159845

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486715

**C.nr.2997/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesional L.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Y.S. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. F.S. nga Prizreni, kundër të paditurës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH. A., me seli në Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, me objekt të kontestit: anulimi i vendimit, jashtë seance, me datën **21.03.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET e tërhequr** padia e paditësit Y.S. nga Prizreni, me shenjën C.nr.2997/2023, kundër të paditurës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH. A., me seli në Prizren, me objekt kontesti anulim i vendimit, në këtë çështje kontestimore.

**II. OBLIGOHET** paditësi Y.S. nga Prizreni, që të paditurës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH. A., me seli në Prizren, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 410.50 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj gjykate paditësi Y.S. nga Prizreni, nëpërmjet të autorizuarit të tij av. F.S. nga Prizreni më datë 25.07.2023, ka parashtruar padinë kundër të paditurës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH. A., me seli në Prizren, me objekt të kontestit: anulimi i vendimit.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, me parashtrësën e datës 18.03.2024 i autorizuari i paditësit av. Forti Skoro ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga padia e parashtruar nga paditësi Y.S. kundër të paditurës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH. A., pasi që paditësi është kthyer në vendin e punës tek e paditura.

Duke vepruar sipas kërkesës së paditësit Y.S. të parashtruar përmes të autorizuarit të tij, për tërheqjen e padisë, gjykata e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit Y.S. duke u bazuar në

neni 261 par. 2 të LPK-së, është përcaktuar që *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë”*. I autorizuari i të paditurit av. B.M. gjatë shqyrtimit përgatitor e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë, por i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore, dhe atë për përpilimin e përgjigjes në masë të sigurisë dhe përgjigjes në padi dhe atë nga 104.00 euro për secilën si dhe për përfaqësim në seancën lidhur me masën e sigurisë dhe në seancën e sotme në lartësi prej 135 euro për secilën seancë, apo shumën e përgjithshme prej 478.00 euro.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 456 par.1 të LPK-së ku është përcaktuar se *“Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit”*, lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, ku përcakton se *“ Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalishtë lidhur me kërkesën.”*, ndërsa me paragrafin 4 të njëjtit nen parashihet që *“Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendos në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate”* dhe atë për përpilimin e përgjigjes në masë të sigurisë dhe përgjigjes në padi nga 104.00 euro për secilën (2 x 104.00=208.00) si dhe për përfaqësim në seancën lidhur me masën e sigurisë në lartësi prej 135 euro dhe për seancën e datës 20.03.2024 të cilën ka prezantuar avokati i të paditurës, shuma prej 50 % të shpërblimit - tarifës apo shumën prej 67.50 euro për seancë, apo shumën e përgjithshme prej 410.50 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 261 par. 2 të LPK-së vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe në kuptim të nenit 456 par. 1 dhe 463 par.1 të LPK-së, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.2997/2023, datë 21.03.2024**

**Gjyqtari**

---

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLA JURIDIK:** Kundër pikës I të këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së, ndërsa kundër pikës II të këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.